



121 14 01 2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 6, datë 12.1.2016

PËR

**MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS  
SË ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT TË QARKUT  
TË TIRANËS**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Struktura e administratës së prefektit të qarkut të Tiranës të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e administratës së prefektit të qarkut të Tiranës të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të administratës së prefektit të qarkut të Tiranës të jetë, gjithsej, 31 veta.
4. Urdhri nr.65, datë 10.4.2006, i Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së prefektit të qarkut të Tiranës", si dhe urdhri nr.33, datë 21.2.2014, i Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së nënprefektit të Kavajës", shfuqizohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA